

PERIUDHA E ZBATIMIT TË GRANTEVE

Faza I

- Procesi zgjat rreth katër muaj, prej momentit të fillimit të shpërndarjes së informacionit, lajmërimeve, vlerësimit dhe kontraktimit).
- Thirrja zyrtare do të shpallet në datën 2 maj 2016 në mjetet e informimit publik, dhe do të jetë e vlefshme për 6 javë.
- 10 grante të mëdha, të zbatueshme për një periudhë prej 24 muajsh.
- 8 grante të vogla dhe të mesme, të zbatueshme për një periudhë 12-mujore.

Faza II

- Procesi zgjat rreth 3 (tre) muaj prej momentit të fillimit të shpërndarjes së informacionit, lajmërimeve, vlerësimit dhe kontraktimit).
- Thirrja zyrtare do të shpallet në datën 3 prill 2017 në mjetet e informimit publik, dhe do të jetë e vlefshme për 6 javë.
- 16 grante të vogla/të mesme, të zbatueshme për një periudhë 12-mujore.

Ky botim publikohet në kuadër të projektit "Përfshirja Sociale për një sistem drejtësie funksional dhe të hapur në Shqipëri" i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave ligjore të Integruara.

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara

Blv. "Gjergj Fishta" Kulla V Ap. 24
Tiranë, Shqipëri
Tel: + 355 42223880/69307
E-Mail: office@qshpli.org
www.qshpli.org

Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri

ABA Business Center, Rr. Papa Gjon Pali II, kati 117-të, Tiranë – Albania
Tel: (+355) 4 222 8320 or 223 0871/222 8479/223 4284
Email: delegation-albania@eeas.europa.eu
http://eeas.europa.eu/delegations/albania

Save the Children

Rr. Komuna e Parisit,, Lagjia 8,
Pallatet I Maji, Vila "Lami", P.O. Box 8185
Tel: +355 4 2261840 / 2261929
E-Mail: info.albania@savethechildren.org
https://albania.savethechildren.net



Projekt i financuar nga
Bashkimi Evropian

Përfshirja Sociale për një sistem drejtësie funksional dhe të hapur në Shqipëri



Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (CILSP)



Save the Children

INFORMACIONI PËR PËRGJITHSHËM MBI PROJEKTIN

Kohëzgjatja

janar 2016 – dhjetor 2018

Shtrirja Gjeografike

Shqipëri (Popullata në përgjithësi, përfshirë grupet në nevojë, të rinj në kontakt me ligjin dhe familjet e tyre do të përfitojnë nga një sistem drejtësie i përmirësuar).

Buxheti total

1,284,093.41 EUR

Kontributet e Projektit

Projekti do të kontribuojë në fuqizimin e Shoqërisë Civile, e cila merr pjesë aktive dhe influencon në funksionimin e duhur të sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Organizatat e Shoqërisë Civile do të forcohen dhe do të ndihmojnë në rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë së sistemit të drejtësisë dhe do të përmirësojnë aksesin e grupeve në nevojë në këtë sistem.

Përfituesit e drejtpërdrejtë

Organizatat e Shoqërisë Civile të përfshira në monitorimin e sistemit të drejtësisë dhe aksesin në drejtësi (OJF, shoqata rinore dhe studentore në fushën e drejtësisë, iniciativa qytetare, etj) ndërmjet të cilave:

- 75 OJF që do të marrin pjesë në aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve të tyre.
- 34 OJF që do të përfitojnë grante.
- 40 OJF që do të bëhen pjesë e rrjetit.

Përfituesit indirektë

- Rreth 2 milion qytetarë në shtatë rrethe gjyqësore të vendit, midis të cilëve edhe grupe në nevojë, veçanërisht të rinj në kontakt me ligjin dhe familjet e tyre, si edhe popullata në përgjithësi nga një sistem drejtësie i përmirësuar.
- Anëtarë të institucioneve të drejtësisë, universitetet dhe profesorët.

Rezultatet e pritshme

- Përmirësim i kapaciteteve të OJF-ve pjesëmarrëse mbi zhvillimin e tyre organizativ, monitorimin e sistemit të drejtësisë, aksesin në drejtësi, advokim dhe lobim.
- OJF-të aftësohen për të monitoruar sistemin e drejtësisë dhe krijojnë akses të barabartë dhe efektiv nëpërmjet zbatimit të projekteve të financuara nga skema e granteve.
- Rrjeti i Shoqërisë Civile krijohet dhe funksionon si përfaqësues në institucionet e sistemit të drejtësisë në nivel lokal dhe kombëtar.

INICIATIVA E GRANTEVE NË KUADËR TË PROJEKTIT

Shuma totale e granteve

900,000.00 EUR

Numri i granteve

34

Shuma për grant

10,000.00 - 15,000.00 EUR (Grante të vogla)
20,000.00 - 25,000.00 EUR (Grante të mesme)
40,000.00 - 50,000.00 EUR (Grante të mëdha)

Fushat e mundshme të projekteve për mbështetje

Monitorimi:

- Efikasiteti i sistemit të drejtësisë (të dhëna të disagreguara, kohëzgjatja e proceseve, qartësim i rasteve në proces, të zgjidhura dhe në prurje, eficaenca e sistemit të drejtësisë përballë buxhetit të alokuar).
- Cilësia e sistemit të drejtësisë (ekzistenca e gjykatave/gjykatësve/avokatëve të specializuar, ndërtimi i vazhdueshëm i kapaciteteve/trajnimet, frekuenca dhe kriteret e transferimit, përdorimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, përdorimi i zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve, zbatimi i vendimeve ligjore, vlerësimi i vendimeve gjyqësore).
- Monitorimi i institucioneve monitoruese (monitorimi i inspektoriatit të gjykatave dhe vlerësimet, transparenca dhe monitorimi).

Aksesi në drejtësi

- Përmirësimi i aksesit në drejtësi nëpërmjet ndihmës ligjore falas për grupet në nevojë dhe promovimi i qëndrimit miqësor në drejtësi (përfshirja e studentëve të drejtësisë, klinikat ligjore).
- Konsolidimi dhe promovimi i zgjidhjeve alternative për grupet në nevojë (ndërmjetësimi, zgjidhjet alternative në shkollat dhe komunitetet).
- Konsolidimi dhe promovimi i të drejtave të viktimeve/dëshmitarëve dhe mbrojtja (ndërtimi i kapaciteteve me profesionistët, dhomat e hetimit).
- Ndihma ligjore falas (përkrahja e komisionit shtetëror mbi ndihmën ligjore falas (duke përfshirë edhe zyrtarë rajonale), ndërgjegjësimi i publikut për ndihmën ligjore falas, promovimi i modelit të ndihmës ligjore pro-bono.